



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA SUPREME

ARJ nr.29/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Nebojša Borčić dhe Zenel Leku anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në çështjen juridike sipas padisë në konfliktin administrativ të paditësit, “M”, Sh.p.k., me seli në Gj., sipas autorizimit e përfaqësojnë avokatët Shabi Isufi dhe Kushtrim Isufi nga Gjilani, kundër të paditurit Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), e R. Kosovës me seli në P., me bazë juridike anulim i vendimit të paditurit, nr. ref. 01/63, të dt.21.08.2023, dhe kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditësit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Dhoma e Shkallës së Dytë, Kom.Dh.Sh.II.nr.1676/23 të datës 21.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 28 Mars 2024, merr këtë :

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi, “M”, sh.p.k., me seli në Gj., kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Dhoma e Shkallës së Dytë, Kom. Dh. Sh. II. nr. 1676/23, të datës 21.12.2023.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Dhoma e Shkallës së Dytë, refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit-propozuesit, “M”, sh.p.k., me seli në Gj., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, K.A. Nr. 404/2023 i datës 10.10.2023, vërtetohet.

Kundër aktvendimit të lartë cekur të Shk. së II-të, të Gjykatës Komerciale, paditësi, për mes përfaqësueseve të lartë cekur, në afat ligjor në Gjykatë Supreme parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të; shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim të aprovohet kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm e paditësit, të prishet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Kom. Dh. Shk. II. nr. 1676/23, i dt. 21.12.2023, dhe çështja të kthehet në rivendosje ,apo i njëjti të ndryshohet , ashtu që të aprovohet propozimi i paditësit dhe të shtyhet ekzekutimi i vendimit të MINT nr. ref.01/63, i datës 21.08.2023, deri sa të merret vendimi përfundimtarë nga gjykata sipas padisë së paditësit të ushtruar në gjykatë lidhur me këtë çështje.

Gjykata Supreme në përputhje me nenin 53 të LKA-së mbajti seancën, vlerësoi pretendimet e paraqitura në kërkesë, ekzaminoi aktvendimin e kontestuar të Dhomës së shkallës së dytë dhe atë të shkallës së parë dhe pas shqyrtimit edhe të akteve të tjera të lëndës gjen se;

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga aktet e lëndës rezulton se, me aktvendimin e Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative K.A. Nr. 404/2023, të datës 10.10.2023, refuzohet si e pa bazuar kërkesa e paditësit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, nr.01/63, të datës 21.08.2023, i nxjerrë nga e paditura, Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Dhoma e Shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale në procedurë ankimore me aktvendimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur si në kuptim të nenit 13, par.6.1, të Ligjit 08/L015, dhe 194, të LPK-së, ( ligj i aplikueshëm në kuptim të nenit 63 të LKA-së), e refuzon ankesën e paditësit si të pa bazuar ndërsa aktvendimin e shkallës së parë e vërteton. Në arsyetim pasi bënë përshkrimin e gjendjes së vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, e pranon në tërësi së të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të saj, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit në rastin konkret nga paditësi nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur, ashtu si parashihet në nenin 22 të LKA-së. Sipas vlerësimit të kolegjit gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar rrethanat faktike me refuzimin e kërkesës së paditësit, sepse kërkesa tërësisht është e mbështetur në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore për të cilat gjykata do të vendos në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesës padisë për anulimin e vendimit të kontestuar, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e bazueshmërisë së kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar. Mbi këtë gjendje të fakteve vlerëson se dhoma e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejt ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me refuzimin e kërkesës së paditësit, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të palës ankuese, andaj pretendimet e paditësit në ankesë i refuzon si të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, dhe konstaton se aktvendimi i shkallës së parë është i qartë i kuptueshëm ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes si më lartë, vlerësimi të pretendimeve në kërkesë, ekzaminimit të aktvendimit të kontestuar të Dhomës së Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale dhe të shkallës së parë si dhe akteve tjera të lëndës vlerëson se, dhoma e shkallës së dytë ka vendosur drejtë dhe në baza ligjore me refuzimin e ankesës së paditësit dhe vërtetimin e aktvendimit të shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Dhomës së shkallës së dytë por edhe të Shkallës së parë në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë meqë aktvendimet e kontestuara nuk janë të përfshirë me shkelje të esenciale të dispozitave të procedurale nga neni 22 të LKA, të LPK-së, e po ashtu nuk është bërë zbatim i gabuar i të drejtës materiale ashtu si pretendohet në kërkesë. Aktvendimet e kontestuar janë të qartë dhe të kuptueshëm e po ashtu përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare dhe konkrete të vërtetuara, sipas së cilave ka rezultuar se kërkesa-propozimi i paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur është e pa bazuar.

Sipas nenit 22, të Ligjit për Konfliktet Administrative parashihet se, me kërkesën e paditësit akti i organit i cili ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja nuk do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Ndërsa me dispozitën e nenit 22, paragraf 6 të njëjtit ligj, përcaktohet se paditësi mund të kërkoj edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate paditësi nuk arrin të dëshmojë me prova bindëse mbështetjen e kërkesës së tij, se me ekzekutimin e vendimit të organit administrativ do ti shkaktohej dëm i cili vështirë do të riparohej, që shtyrja-pezuillimi i ekzekutimit të vendimit të kontestuar nuk është në kundërshtim me interesin publik, dhe shtyrja nuk do ti shkaktonte dëm të pa riparueshëm apo të madh palës kundërshtare-kundër propozuesit, përkatësisht palës së interesuar. Pra në çështjen juridike konkrete edhe sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, nga paditësi nuk janë plotësuar kushtet ligjore si parashihen në nenin 22, të LKA-së në mënyrë kumulative të cilat janë të domosdoshme që pastaj gjykata të nxjerrë vendim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit administrativ të paditur gjer në vendosjen meritore të çështjes sipas padisë me vendim të plotfuqishëm gjyqësor.

Pretendimet në kërkesë se, gjykatat e instancave më të ulëta nuk i kanë shqyrtuar pretendimet ankimore dhe nuk kanë dhënë arsye mbi refuzimin e ankesës, se paditësit po i shkaktohet dëm i madh me refuzimin e kërkesave të tij të një pas njëshme, se aktvendimi i atakuar është kontradiktor me vetveten dhe në kundërshtim me nenin 22 të LKA , sepse me mos shtyrjen e ekzekutimi të vendimit të M., i sillet dëm i pa riparueshëm sepse të njëjtit i mohohet konkurrenca në treg dhe do ti pamundësohej të zhvilloj biznesin më tutje dhe pagesën e të punësuarve ,se mbulon 25% të prodhimit vendor, dhe shtyrja është në interes publik me që mbrohet prodhim vendor që mbulohet 100%,andaj për veç paditësit dëm i shkaktohet edhe prodhueseve të tjerë dhe bujqve prej të cilëve merret lënda e parë. Kolegji i Gjykatës Supreme këto pretendime dhe të tjerat si në kërkesë në këtë drejtim i vlerëson se nuk janë të bazuara në prova dhe fakte të argumentuara. Pretendimet në kërkesë janë të përgjithësuara, deklarative pa mbështetje në prova konkrete valide në drejtim të dëmit konkret që i shkaktohet paditësit, apo dëmtimit të interesit publik ashtu si e thekson, nëse nuk shtyhet ekzekutimi i vendimit të organit të paditur gjer në vendosjen meritore të çështjes, i cili vështirë do të riparohej ashtu si parashihet me nenin 22.2, lidhur me parag. 6, të LKA-së. Andaj si të tilla nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe në këtë çështje nga ajo e vendosur nga Dhoma e shkallës së dytë, për deri sa janë të qëndrueshme konstatimet e gjykatave më të ulëta se pretendimet kanë të bëjnë më shumë me vendosjen meritore të kësaj çështje duke e patur për bazë natyrën e çështjes së vendosur si në vendimet e organit të paditur të M.. Ndërprerjen e masës mbrojtëse Antidamping mbi sektorin e prodhimit të koncentratit për shpezë dhe kafshë nga Serbia, dhe obligimin që Dogana e Kosovës të zbatoj këtë vendim. Për ligjshmërinë e vendimit të organit të paditur gjykata vendos pas shqyrtimit të kësaj çështje në procedurë të rregullt gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur e jo në fazë të vendosjes procedurale për masë të përkohshme për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit.

Nga sa u parashtrua si më lartë dhe në bazë të nenit 54, par.1, lidhur me nenin 22, par.2 dhe 6, të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË  
ARJ nr. 29/2024, me datë 28 Mars 2024

B. Profesionale,  
Zanë Buçinca

Kryetari i kolegjit,  
Ragip Namani